



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MJEDISIT

GUSHT 2026

BULETINI MUJOR

MINISTRIA E MJEDISIT



Ministri Jaupaj takim për prioritetet me ekipin e Mjedisit

Ministria e Mjedisit synon të jetë më pranë qytetarëve dhe eksperiencës së tyre të përditshme, me më shumë vëmendje për promovimin dhe mbrojtjen e pasurive tona mjedisore, si edhe me hapa konkretë për përmirësimin e infrastrukturës së trajtimit të mbetjeve dhe standardeve mjedisore në të gjithë territorin.



Përmbyllet me sukses aksioni "Male të Pastra"

Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura, në bashkëpunim me drejtoritë rajonale, janë pjesë e nismës "Male të pastra", një aksion kombëtar pastrimi që u zhvillua ditën e sotme, datë 26 gusht, në 11 vendndodhje të ndryshme të parqeve kombëtare dhe natyrore. Nxënës, studentë e qytetarë iu bashkuan stafit e Zonave të Mbrojtura në këtë aksion kombëtar.



Sistem i ri për menaxhimin e mbetjeve në të gjithë Shqipërinë.

Ministri Jaupaj njoftoi një sistem të ri për të gjithë Shqipërinë, me një synim të qartë: më pak ndotje, më shumë riciklim dhe qytete më të pastra. Nga qendrat e reja të kompostimit në Kukës, Lezhë, Gramsh e Shkodër, te rehabilitimi i venddepozitimit të vjetër në Vlorë dhe investimet e reja në infrastrukturën e mbetjeve, synohet menaxhi sa më efikas i mbetjeve në territor.



MJEDISI 365.

Mjedisi 365: 10 programe, një vizion për Shqipërinë e Gjelbër.

Gjatë muajit gusht u prezantua Paketa "Mjedisi 365", e strukturuar në 10 programe që adresojnë prioritetet kryesore mjedisore: menaxhimin dhe riciklimin e mbetjeve, pyjet dhe gjelbërimin, zonat e mbrojtura, biodiversitetin, lumenjtë, monitorimin mjedisor dhe angazhimin e të rinjve përmes Korpusit të Gjelbër Shqiptar. Paketa synon t'i kthejë këto prioritete në programe konkrete me ndërhyrje dhe rezultate të matshme në territor.

Miratohej dy urdhra të Ministrit për forcimin e përgjegjësisë mjedisore

Në muajin gusht u miratuan dy akte që forcojnë kuadrin e përgjegjësisë mjedisore, duke përcaktuar si masat për rehabilitimin e mjedisit të dëmtuar, ashtu edhe metodën për vlerësimin e kostove të parandalimit dhe riparimit të dëmit. Kuadri i ri synon rikthimin e burimeve natyrore dhe ekosistemeve të dëmtuara, rritjen e përgjegjësisë së operatorëve dhe zbatimin konkret të parimit "Ndotësi Pague".



Gushti sjell rritje të vizitorëve në Zonat e Mbrojtura

Gjatë muajit gusht 2026, Zonat e Mbrojtura të Shqipërisë pritën 1,446,942 vizitorë, duke shënuar një rritje prej 6.6% krahasuar me gushtin 2025. Në periudhën janar-gusht 2026, numri i përgjithshëm i vizitorëve arriti në 4,560,491, rreth 11.8% më shumë se në të njëjtën periudhë të një viti më parë.